

**THE OPEN GOVERNMENT PARTNERSHIP
NATIONAL ACTION PLAN FOR ALBANIA
2026 – 2030
CONSULTATION SUMMARY 2**



CONSULTATION 2

Consultation Details

Policy Goal Focus	<p>Angazhime të propozuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Forcimi i kapaciteteve teknike të strukturave institucionale me kompetenca parandalimi të korrupsionit; 2. Vlerësimi i riskut të korrupsionit në administratën publike me fokus sektorët vulnerabël sipas SNKK; 3. Forcimi i bashkëpunimit midis sektorit publik dhe privat në uljen e incidencës së korrupsionit; 4. Përmirësimi i ndërveprimit të autoriteteve publike në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe grupet e interesit; 5. Zbatimi i kurrikulës së integritetit dhe informimit për luftën kundër korrupsionit në arsimin parauniversitar. 6. Forcimi i integritetit dhe transparencës publike në vendimmarrjen publike (<i>propozim OSHC</i>)
Lead Focal Point Institution	<p>Znj. Rovenia Pregja / Drejtor i Drejtorisë së Zbatimit të Politikave në Fushën Antikorrupsion, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit</p> <p>Znj. Viktoria Spiro / Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit dhe Koordinimit të Politikave Prioritare, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit</p> <p>Z. Hener Shanaj / Specialist i Sektorit të Monitorimit dhe Koordinimit të Politikave Prioritare, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit</p>
Date	17.03.2026
Consultation Meeting Number	2

I. Objective of Consultation Meeting

What was the aim of this consultation? Please answer for all that apply	<p>Details:</p> <p>Takimi i dytë konsultativ kishte si qëllim vijimin e procesit të bashkë-krijimit (<i>co-creation</i>) të Planit Kombëtar të Veprimit për OGP 2026–2030, përmes angazhimit aktiv të organizatave të shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë të interesit.</p> <p>Në këtë kuadër, takimi synoi të prezantojë dhe të diskutojë rezultatet e mbledhura nga faza e parë e konsultimit, përfshirë kontributet e dhëna përmes pyetësorit, të sigurojë një hapësirë të strukturuar dialogu për shqyrtimin e propozimeve të paraqitura nga OSHC gjatë takimit të parë të datës 05.03.2026 si dhe të mbështesë përfshirjen domethënëse të palëve të interesit në rishikimin dhe konsolidimin e angazhimeve të propozuara në kuadër të komponentit “Lufta kundër Korrupsionit”.</p> <p>Takimi kontribuoi në forcimin e një procesi gjithëpërfshirës dhe transparent, duke mundësuar marrjen e komenteve dhe propozimeve konkrete për formulimin e masave dhe aktiviteteve të reja, në përputhje me prioritetet e Planit të Veprimit të OGP dhe me parimet e qeverisjes së hapur.</p>
(i) Introduce stakeholders to the proposed policy goal	<p><input type="checkbox"/> No / <input checked="" type="checkbox"/> Yes</p> <p>Në kuadër të procesit të konsultimit, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit prezantoi para palëve të interesuarit fushat prioritare të ndërhyrjes në komponentin</p>

	<p>“Lufta kundër Korrupsionit”, në përputhje me mandatin institucional dhe me angazhimet e Shqipërisë në kuadër të Partneritetit për Qeverisjen e Hapur (OGP).</p> <p>Në këtë kontekst, u theksua se lufta kundër korrupsionit përbën një prioritet kyç të politikave publike dhe është e institucionalizuar në Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024–2030, e cila përcakton objektivat strategjike për forcimin e integritetit, transparencës dhe llogaridhënies në administratën publike.</p> <p>Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit prezantoi drejtimet kryesore të angazhimeve të propozuara, të cilat fokusohen në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - forcimin e mekanizmave të parandalimit të korrupsionit; - zhvillimin dhe konsolidimin e instrumenteve të integritetit institucional; - rritjen e kapaciteteve teknike të strukturave përgjegjëse; - avancimin e vlerësimit të riskut të korrupsionit, veçanërisht në sektorët më vulnerabël; - përmirësimin e bashkëpunimit ndër-institucional dhe ndërsektorial. <p>Në përputhje me parimet e OGP për qeverisje të hapur, angazhimet e propozuara synojnë gjithashtu:</p> <ul style="list-style-type: none"> - forcimin e bashkëpunimit ndërmjet sektorit publik dhe atij privat; - rritjen e rolit të shoqërisë civile dhe grupeve të interesit në proceset e transparencës dhe llogaridhënies; - promovimin e edukimit për integritetin dhe ndërgjegjësimin kundër korrupsionit, përfshirë në sistemin arsimor parauniversitar; - avancimin e transparencës dhe integritetit në proceset e vendimmarrjes publike. <p>Procesi i konsultimit është zhvilluar në përputhje me parimet e gjithëpërfshirjes, transparencës dhe pjesëmarrjes aktive të palëve të interesit. Pjesëmarrësit janë njoftuar paraprakisht për qëllimin dhe përmbajtjen e takimit, si pjesë e një procesi të vazhdueshëm që bazohet në analizën e të dhënave të mbledhura përmes pyetësorit dhe në vijimësinë e diskutimeve të zhvilluara në takimet e mëparshme.</p>
<p>(ii) Introduce stakeholders to the OGP process</p>	<p><input type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <p>Në kuadër të takimit të dytë konsultativ, pjesëmarrësve iu prezantua në mënyrë të strukturuar procesi i Partneritetit për Qeverisjen e Hapur (OGP), me fokus të veçantë në qasjen e bashkë-krijimit (<i>co-creation</i>) për hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit 2026–2030.</p> <p>Në takim u ftuan rreth 65 përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile me ekspertizë në fushën e antikorrupsionit, të cilëve iu ofrua informacion i detajuar mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - fazat e procesit të hartimit të Planit të Veprimit; - rolin dhe kontributin e palëve të interesit në këtë proces; - mekanizmat e përfshirjes dhe konsultimit në kuadër të OGP. <p>Diskutimi u fokusua në mënyrë të veçantë në angazhimin “Lufta kundër Korrupsionit”, duke nxitur pjesëmarrjen aktive të OSHC-ve në rishikimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të propozimeve, në përputhje me parimet e transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse.</p>
<p>(iii) Explain the feedback tools for stakeholders</p>	<p><input type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <p>Gjatë takimit të dytë konsultativ, pjesëmarrësve iu prezantuan qartësisht mekanizmat dhe instrumentet e përdorur për mbledhjen dhe integrimin e <i>feedback</i>-ut në procesin e bashkë-krijimit të Planit të Veprimit.</p> <p>Në këtë kuadër, përfaqësuesja e Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit Znj. Rovena Pregja prezantoi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përmbledhjen e kontributeve të mbledhura gjatë fazës së parë të konsultimit; - raportin e konsultimit të takimit të parë, i cili u nda për shqyrtim dhe validim nga pjesëmarrësit; - draftin e angazhimeve të propozuara për komponentin “Lufta kundër Korrupsionit”. <p>Pjesëmarrësve iu ofrua mundësia të kontribuojnë në mënyrë aktive përmes:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - diskutimeve të hapura gjatë takimit; - dhënies së komenteve dhe sugjerimeve për riformulimin e angazhimeve; - validimit të përmbajtjes së draftit të Planit të Veprimit. <p>Procesi i feedback-ut u zhvillua në mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse, duke mundësuar reflektimin e kontributeve të marra nga organizatat e shoqërisë civile në përmirësimin e mëtejshëm të angazhimeve.</p> <p>Raporti i konsultimit të takimit të parë u prezantua dhe u miratua në mënyrë të përbashkët nga pjesëmarrësit, duke shërbyer si bazë për zhvillimin e mëtejshëm të procesit.</p>
<p>(iv) Brainstorm ideas with stakeholders</p>	<p><input type="checkbox"/> No / <input checked="" type="checkbox"/> Yes</p> <p>Takimi i dytë konsultativ përfshiu një komponent të strukturuar shkëmbim idesh, i cili synoi gjenerimin dhe përmirësimin e ideve në lidhje me angazhimet e propozuara.</p> <p>Gjatë këtij procesi, pjesëmarrësit kontribuan me komente, sugjerime dhe propozime konkrete për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - rishikimin dhe përmirësimin e angazhimeve të propozuara nga DPAK; - identifikimin e prioriteteve kryesore ndërmjet angazhimeve të ndryshme; - riformulimin dhe konsolidimin e masave në një numër më të kufizuar dhe më të fokusuar angazhimesh. <p>Diskutimi u zhvillua në mënyrë të hapur dhe interaktive, duke mundësuar arritjen e një niveli paraprak dakordësie mbi drejtimit kryesore të angazhimeve që do të përfshihen në Planin e Veprimit.</p> <p>Ky proces kontribuoi në forcimin e bashkë-krijimit, duke reflektuar qasjen e OGP për përfshirje aktive dhe domethënëse të palëve të interesit në hartimin e politikave publike.</p>
<p>(v) Develop further details (milestones, etc.) for ideas</p>	<p><input checked="" type="checkbox"/> No / <input checked="" type="checkbox"/> Yes</p> <p>Gjatë takimit të dytë konsultativ, pjesëmarrësve iu prezantuan elementë më të detajuar të angazhimeve të propozuara, duke përfshirë veprimet kryesore (<i>milestones</i>) dhe hapat e mundshëm për zbatimin e tyre.</p> <p>Diskutimi u fokusua në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - konkretizimin e angazhimeve përmes përcaktimit të veprimeve të matshme dhe të zbatueshme; - forcimin e sistemeve të integritetit institucional, përmes hartimit dhe zbatimit të planeve të integritetit në institucionet publike prioritare, përfshirë ndërmarrjet shtetërore; - rritjen e kapaciteteve të drejtuesve institucionalë dhe strukturave përgjegjëse për integritetin; - përmirësimin e transparencës dhe integritetit në proceset e vendimmarrjes publike. <p>Gjatë diskutimit u evidentua se një pjesë e angazhimeve janë tashmë në zbatim, ndërsa të tjera kërkojnë riorganizim ose forcim të mëtejshëm. Në këtë drejtim, u theksua nevoja për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përqendrimin e angazhimeve në një numër të kufizuar prioritete; - shmangien e mbivendosjeve ndërmjet masave; - rritjen e efektivitetit dhe zbatueshmërisë së tyre. <p>Gjithashtu, u nënvizua rëndësia e bashkëpunimit ndër-institucional dhe me shoqërinë civile, si dhe domosdoshmëria që angazhimet të bazohen në iniciativa konkrete dhe të realizueshme.</p> <p>Në përfundim, u dakordësua që drafti i Planit të Veprimit të konsolidohet më tej dhe të paraqitet për shqyrtim në fazën pasuese të procesit.</p>
<p>(vi) Gather feedback on proposed policy goals</p>	<p><input type="checkbox"/> No / <input type="checkbox"/> Yes</p> <p>Takimi i dytë konsultativ u zhvillua në format diskutimi të hapur, me fokus mbledhjen e feedback-ut nga pjesëmarrësit mbi raportin e konsultimit të takimit të parë dhe mbi angazhimet e propozuara në kuadër të komponentit “Lufta kundër Korrupsionit”. Gjatë takimit, pjesëmarrësit patën mundësinë (i) të paraqesin komente dhe sugjerime konkrete</p>

	<p>mbi përmbajtjen e angazhimeve; (ii) të propozojnë riformulime dhe përmirësime të masave të propozuara; (iii) të kontribuojnë në orientimin e mëtejshëm të zhvillimit të angazhimeve.</p> <p>Kontributet e dhëna nga organizatat e shoqërisë civile dhe aktorët e tjerë pjesëmarrës u reflektuan si pjesë e procesit të bashkë-krijimit dhe do të merren në konsideratë në fazat e mëtejshme të hartimit dhe konsolidimit të Planit të Veprimit të OGP.</p> <p>Procesi i mbledhjes së feedback-ut u zhvillua në mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse, në përputhje me parimet e OGP për pjesëmarrje domethënëse të palëve të interesit.</p>
(vii) Prioritize proposed policy goals	<p><input type="checkbox"/> No / <input checked="" type="checkbox"/> Yes</p> <p>Gjatë diskutimeve u evidentua nevoja për përqendrimin e angazhimeve në një numër të kufizuar prioritetesh; përmbledhjen e propozimeve në 2–3 angazhime kryesore, me qëllim rritjen e qartësisë dhe zbatueshmërisë së tyre; shmangien e mbivendosjeve ndërmjet masave të propozuara.</p> <p>Procesi i prioritizimit do të vijojë në fazën pasuese, përmes hartimit dhe konsolidimit të draftit të parë të Planit të Veprimit, i cili do t'i paraqitet për shqyrtim Komitetit Shumëpalësh në muajin prill.</p> <p>Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit do të riformulojë angazhimet në tre gjithsej, mbështetur në diskutimet e bëra në takimin e ditë së sotme dhe do të ndaj atë pr konsultimin e radhës.</p>
(viii) Other (provide details)	<p><input checked="" type="checkbox"/> No / <input type="checkbox"/> Yes</p> <p>Nuk u evidentuan elementë të tjerë shtesë përtej komponentëve të trajtuar më sipër në kuadër të këtij takimi konsultativ.</p>
II. Methodology	
<p>What was the format of the meeting?</p> <p>How were stakeholders able to participate?</p>	<p>Takimi i dytë konsultativ u organizua fizikisht, në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit.</p> <p>Metodologjia e ndjekur synoi të garantojë një proces gjithëpërfshirës dhe ndërveprues, duke mundësuar pjesëmarrjen aktive të palëve të interesit përmes kombinimit të prezantimeve, diskutimeve të hapura dhe shkëmbimit të ideve.</p> <p>Struktura e takimit u mbështet në një agjendë të shpërndarë paraprakisht, e cila përfshinte (i) prezantimin dhe miratimin e raportit të konsultimit të takimit të parë; (ii) prezantimin e draftit të angazhimeve dhe masave të propozuara; (iii) diskutime dhe propozime nga pjesëmarrësit për riformulimin dhe përmirësimin e angazhimeve si dhe (iv) përmbledhjen e diskutimeve dhe përcaktimin e hapave të mëtejshëm të procesit.</p> <p>Kjo qasje metodologjike kontribuoi në sigurimin e një procesi transparent, të strukturuar dhe të orientuar drejt bashkë-krijimit, në përputhje me parimet e OGP.</p>
(i) Presentations	<p><input type="checkbox"/> No / <input checked="" type="checkbox"/> Yes</p> <p>Takimi konsultativ përfshiu prezantime të strukturuar, të mbështetura në agjendën e shpërndarë paraprakisht tek pjesëmarrësit.</p> <p>Në kuadër të prezantimeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> • u paraqit dhe u diskutua raporti i konsultimit të takimit të parë, i cili u hodh për shqyrtim dhe miratim nga pjesëmarrësit; • u prezantua drafti i angazhimeve, si dhe masat dhe aktivitetet e propozuara në

	<p>fazën e parë të procesit;</p> <ul style="list-style-type: none"> • u ofrua një pasqyrë e përgjithshme mbi drejtimit kryesore të ndërhyrjes në kuadër të komponentit “Lufta kundër Korrupsionit”. <p>Prezantimet shërbyen si bazë për diskutimet e mëtejshme, duke mundësuar një kuptim të përbashkët të përmbajtjes së draftit dhe orientimin e kontributeve të palëve të interesit.</p>
(ii) Discussion / Feedback from stakeholders	<p><input type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <p>Gjatë takimit u zhvillua një diskutim i hapur mbi raportin e konsultimit të takimit të parë dhe mbi angazhimet e propozuara në kuadër të komponentit “Lufta kundër Korrupsionit”. Pjesëmarrësit kontribuan me komente dhe sugjerime konkrete, duke adresuar përmbajtjen dhe strukturën e angazhimeve. Në vijim të diskutimeve, u arrit një dakordësi paraprake që:</p> <ul style="list-style-type: none"> • angazhimet e propozuara të përmbliidhen në një numër të kufizuar masash konkrete; • të synohet konsolidimi i tyre në maksimumi 2–3 angazhime kryesore, me qëllim rritjen e qartësisë dhe zbatueshmërisë. <p>Diskusimi kontribuoi në orientimin e mëtejshëm të procesit të bashkë-krijimit, duke reflektuar qasjen e OGP për përfshirje aktive dhe domethënëse të palëve të interesit.</p>
(iii) Questions and answers	<p><input type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <p>Gjatë takimit u zhvillua një sesion i hapur pyetje–përgjigje, i cili mundësoi sqarimin e çështjeve të ngritura dhe thellimin e diskutimit mbi angazhimet e propozuara. Pjesëmarrësit patën mundësinë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të kërkojnë sqarime mbi përmbajtjen dhe strukturën e draftit të Planit të Veprimit; • të adresojnë çështje specifike që lidhen me zbatueshmërinë dhe koherencën e angazhimeve; • të ndajnë komente dhe reflektime mbi drejtimit e propozuara. <p>Shkëmbimi i pyetjeve dhe përgjigjeve kontribuoi në rritjen e qartësisë dhe në përmirësimin e cilësisë së angazhimeve, duke reflektuar një proces transparent dhe ndërveprues në përputhje me parimet e OGP.</p>
(iv) Brainstorming	<p><input type="checkbox"/>No / <input checked="" type="checkbox"/>Yes</p> <p>Takimi përfshiu një proces të hapur dhe të strukturuar për gjenerimin e ideve, i cili synoi mbledhjen e propozimeve dhe përmirësimin e mëtejshëm të angazhimeve të propozuara.</p> <p>Gjatë këtij procesi pjesëmarrësit ndanë ide dhe sugjerime mbi përmbajtjen e komponentit “Lufta kundër Korrupsionit”, organizatat e shoqërisë civile paraqitën rekomandime konkrete në lidhje me drejtimit prioritar të ndërhyrjes si dhe u diskutua mbi përmbledhjen dhe konsolidimin e angazhimeve në një numër të kufizuar masash të qarta dhe të zbatueshme.</p> <p>Në përfundim të këtij procesi, u arrit një dakordësi paraprake mbi drejtimit kryesore të angazhimeve dhe nevojën për finalizimin e tyre në fazën pasuese të hartimit të Planit të Veprimit.</p>
Stakeholder Selection	Details
(i) How were stakeholders selected?	<p>Palët e interesit u përzgjedhën në bazë të relevancës së tyre me fushën e antikorrupsionit dhe të përfshirjes së tyre të mëparshme në procese të hartimit dhe monitorimit të politikave publike.</p>

	<p>Në këtë kuadër, fokusi u vendos tek organizatat e shoqërisë civile që kanë ekspertizë dhe veprimtari në fushat e:</p> <ul style="list-style-type: none"> • transparencës dhe llogaridhënies; • integritetit institucional; • parandalimit të korrupsionit. <p>Gjithashtu, përzgjedhja u mbështet në bashkëpunimin ekzistues institucional të DPAK me këto organizata, si dhe në hapjen e procesit përmes njoftimeve publike në faqen zyrtare të institucioni.</p>
(ii) How were stakeholders contacted?	<p>Palët e interesuara u kontaktuan në rrugë elektronike, kryesisht përmes email-it zyrtar si dhe publikimit të njoftimit në medium të ndryshëm si psh; faqja zyrtare e DPAK si dhe në faqen e https://rrjetiantikorrupsion.al/.</p> <p>Ftesa u shoqërua me agjendën e takimit si dhe draftin paraprak të Planit të Veprimit për diskutim, i bazuar në kontributet e mbledhura gjatë dhe pas takimit të parë konsultativ.</p>
(iii) How many stakeholders were contacted?	<p>Rreth 65 palë interesi u kontaktuan përmes email-it. Gjithashtu, informacioni mbi takimin ishte i aksesueshëm për të gjithë anëtarët e regjistruar në platformën www.rrjetiantikorrupsion.al</p>
(iv) Was the consultation announced publically? (via websites, social media, etc.)	<p>Po. Procesi i konsultimit u njoftua publikisht në faqen zyrtare të DPAK, si dhe nëpërmjet komunikimit elektronik nga adresa zyrtare institucionale e Drejtorit të Zbatimit të Politikave në Fushën Antikorrupsion, Znj. Rovena Pregja.</p> <p>Njoftimi publik mundësoi transparencë dhe akses më të gjerë për palët e interesit.</p> <p>Njoftimi në website DPAK: https://antikorrupsioni.gov.al/ftese-e-hapur-per-pjesemarrje-per-organizatat-e-shoqerise-civile-ne-takimin-e-dyte-te-konsultimit-per-bashke-berjen-e-planit-te-ri-te-veprimit-per-partneritet-per-qeverisje-te-hapur-2026-2030-anga/ Njoftimi në website: https://rrjetiantikorrupsion.al/</p>
(v) Were stakeholders reminded?	<p>Po. Palët e interesuara u rikujtuan për zhvillimin e takimit përmes komunikimit elektronik (email), duke siguruar informim në kohë dhe rritje të mundësisë për pjesëmarrje.</p> <p>E-mail për njoftim të zhvillimin e takimit të datës 17.03.2026. (dërguar në datë 10 mars 2026)</p> <p>E-mail rikujtues për zhvillimin e takimit të datës 17.03.2026. (dërguar në datë 13 mars 2026)</p>
III. Results/ Findings	
Stakeholder Contributions	Details
(i) How many stakeholders attended?	Në takimin e dytë konsultativ morën pjesë 11 përfaqësues nga institucione publike dhe organizata të shoqërisë civile.
(ii) Did stakeholders contribute?	Po. Pjesëmarrësit kontribuan në mënyrë aktive gjatë gjithë takimit përmes komenteve, sugjerimeve dhe propozimeve konkrete mbi angazhimet e propozuara.
(iii) Main issues identified by stakeholders	<p>Gjatë diskutimeve u evidentuan disa çështje kryesore që lidhen me nevojën për përfshirje më të strukturuar të organizatave të shoqërisë civile në zbatimin e angazhimeve, rëndësinë e lidhjes së angazhimeve me iniciativa dhe projekte konkrete ekzistuese ose të planifikuara si dhe nevojën për rritjen e efektivitetit dhe zbatueshmërisë së masave të propozuara.</p> <p>Takimi shërbeu gjithashtu për të orientuar palët e interesit drejt ofrimit të propozimeve konkrete dhe të zbatueshme në kuadër të Planit të Veprimit 2026–2030.</p>

<p>(iv) Main recommendations from stakeholders?</p>	<p>Takimi i dytë Konsultativ, përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile dhe aktorët e tjerë pjesëmarrës ndanë rekomandime dhe komente lidhur me aktivitetet e angazhimeve në kuadër të Planit të Veprimit të OGP. Diskutimi u fokusua në rëndësinë e forcimit të mekanizmave të transparencës dhe llogaridhënies në administratën publike, si dhe në nevojën për rritjen e rolit të shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë të interesit në monitorimin e politikave dhe proceseve vendimmarrëse.</p> <p>Gjithashtu, pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e përmirësimit të transparencës në fusha me risk më të lartë korrupsioni, si dhe zhvillimit të mekanizmave që nxisin bashkëpunimin midis institucioneve publike, sektorit privat dhe shoqërisë civile në promovimin e integritetit dhe parandalimin e korrupsionit.</p> <p>Pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e bashkëpunimit dhe koordinimit në lidhje me projektet që ata kanë në plan të realizojnë dhe diskutuan mbi drafte dhe paraqitur me angazhimet kryesore duke dakordësuar që këto angazhime të përmbidheshin në 2-3 angazhime konkrete pasi përfshinin fusha veprimi të njëjta.</p> <p>Këto propozime në formën e rekomandimeve do të merren në konsideratë në fazat e mëtejshme të hartimit të planit të veprimit.</p> <p>Pjesëmarrësit ndanë një sërë rekomandimesh që kontribuojnë në përmirësimin e angazhimeve, ndër të cilat (i) forcimi i mekanizmave të transparencës dhe llogaridhënies në administratën publike; (ii) rritja e rolit të shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë të interesit në monitorimin e politikave dhe proceseve vendimmarrëse; (iii) përmirësimi i transparencës në sektorët me risk të lartë korrupsioni; (iv) zhvillimi i mekanizmave që nxisin bashkëpunimin ndërmjet sektorit publik, sektorit privat dhe shoqërisë civile; (v) sigurimi i një koordinimi më të mirë ndërmjet angazhimeve dhe projekteve konkrete që organizatat planifikojnë të zbatojnë.</p> <p>Gjithashtu, u theksua nevoja për (i) përmbledhjen e angazhimeve në një numër të kufizuar (2–3) angazhimesh kryesore; (ii) shmangien e mbivendosjeve ndërmjet fushave të ndërhyrjes; (iii) rritjen e koherencës dhe fokusit të Planit të Veprimit.</p> <p>Këto rekomandime do të merren në konsideratë në fazat e mëtejshme të hartimit dhe konsolidimit të Planit të Veprimit të OGP.</p>
--	---

IV. Shortcomings Identified & Preparations for Next Consultation	
	Details
<p>(i) Limitations in stakeholder attendance</p>	<p>Jo. Procesi i ftesës ishte gjithëpërfshirës dhe synoi një përfaqësim të gjerë të organizatave të shoqërisë civile, duke kontaktuar rreth 65 përfaqësues përmes kanaleve elektronike.</p>
<p>(ii) Limitations in stakeholder participation</p>	<p>Jo në aspektin procedural. Megjithatë, vihet re një diferencë ndërmjet numrit të palëve të kontaktuar dhe atyre pjesëmarrëse (11 nga 65), gjë që tregon potencial për rritjen e mëtejshme të përfshirjes në fazat e ardhshme të procesit.</p>
<p>(iii) What can be done to improve attendance?</p>	<p>Për të rritur pjesëmarrjen në konsultimet e ardhshme, rekomandohet ndër të tjera forcimi i komunikimit paraprak dhe ndjekja më aktive me palët e interesit, përdorimi i kanaleve të ndryshme të informimit për të arritur një audiencë më të gjerë, sigurimi i kohës së mjaftueshme për planifikimin e pjesëmarrjes si dhe organizimi i takimeve në format hibride (fizik dhe online), për të lehtësuar aksesin.</p>
<p>(iv) What can be done to improve participation in the next meeting?</p>	<p>Për të rritur cilësinë e kontributit dhe angazhimit të palëve të interesit, rekomandohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - forcimi i komunikimit të drejtpërdrejtë dhe i bashkëpunimit të vazhdueshëm me aktorët e interesit; - inkurajimi i pjesëmarrjes përmes theksimit të rolit dhe ndikimit të tyre në procesin e bashkë-krijimit; - shpërndarja paraprake e materialeve dhe dokumenteve për diskutim, për të mundësuar përgatitje më të mirë;

- | | |
|--|--|
| | <ul style="list-style-type: none">- krijimi i hapësirave të strukturuarra për kontribute konkrete gjatë takimeve;- përdorimi i formateve fleksibël (online/hibrid) për të rritur përfshirjen. |
|--|--|

Stakeholder Feedback

Name:	Znj. Rovena Sulstarova	Organization/ Affiliation:	IDM ALBANIA	Position:	
Comments/ Issues Raised /Feedback/ Ideas					
<p>Comments: <i>Përfaqësuesja e IDM Albania theksoi se angazhimi që lidhet me zbatimin e kurrikulës së integritetit dhe informimit për luftën kundër korrupsionit në arsimin parauniversitar është tashmë në proces zbatimi, duke evidentuar se kurrikula përkatëse është në fazë rishikimi.</i></p> <p><i>Në lidhje me angazhimin 1, u vlerësua se, ndonëse është trajtuar edhe në faza të mëparshme, ai duhet të ri-përfshihet për shkak të rëndësisë së tij të vazhdueshme. Në këtë kuadër, IDM Albania parashikon të kontribuojë përmes funksionalizimit të rrjetit të këshilltarëve të etikës, si dhe përmes mbështetjes për hartimin e planeve të integritetit në gjashtë institucione.</i></p> <p><i>Sa i takon angazhimin 4, u bë me dije se organizata planifikon të zhvillojë shtatë procese monitorimi për të vlerësuar zbatimin e rregullave të etikës dhe integritetit.</i></p> <p><i>Në lidhje me angazhimin 6, u sqarua se ky është një propozim i ardhur nga vetë organizata, i cili lidhet me forcimin e integritetit dhe transparencës në vendimmarrjen publike, veçanërisht përmes vlerësimit të integritetit të legjislacionit dytësor.</i></p> <p><i>Gjithashtu, u evidentua se disa angazhime paraqesin mbivendosje në përmbajtje, konkretisht:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • bashkëpunimi publik-privat trajtohet edhe në angazhimin 2; • ndërveprimi me shoqërinë civile dhe grupet e interesit trajtohet edhe në angazhimin 6. 					
<p>Issues Raised: <i>U identifikua nevoja për shmangien e mbivendosjeve ndërmjet angazhimeve dhe për rritjen e koherencës së tyre, përmes ristrukturimit dhe integritetit të përmbajtjeve të ngjashme.</i></p>					
<p>Feedback: <i>U sugjerua që angazhimet 2, 3, 5 dhe 6 të mbeten si angazhime kryesore, ndërsa angazhimet e tjera të përfshihen brenda tyre ose të konsolidohen, me qëllim rritjen e qartësisë, fokusit dhe zbatueshmërisë së Planit të Veprimit.</i></p>					

Name:	Znj. Fabiola Egro	Organization/ Affiliation:	Anëtare e Komitetit Shumëpalësh të PQH	Position:	
Comments/ Issues Raised /Feedback/ Ideas					
<p>Comments: <i>Përfaqësuesja e Komitetit Shumëpalësh të PQH Albania evidentoi se Ministria e Arsimit nuk ka publikuar ende pyetësin në kuadër të këtij procesi, duke ngritur shqetësim për koordinimin ndër-institucional dhe përfshirjen e plotë të aktorëve përkatës.</i></p> <p><i>Gjithashtu, ajo theksoi se, ndonëse Ministria e Drejtësisë ka ndërmarrë hapa për përfshirjen e edukimit ligjor në</i></p>					

ciklin 6–9, ekziston nevoja për përmirësim të mëtejshëm të përmbajtjes dhe shtrirjes së kësaj kurrikule, veçanërisht në arsimin e mesëm, ku vërehet mungesë e njohurive në këtë fushë.

Në këtë kontekst, u ngrit si çështje vlerësimi i mjaftueshmërisë së kurrikulës aktuale dhe nevoja për pasurimin e saj me koncepte dhe përmbajtje shtesë, me qëllim adresimin e nivelit të ulët të angazhimit dhe ndërgjegjësimit të të rinjve.

Gjithashtu, u theksua rëndësia e harmonizimit të prioritetëve ndërmjet organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve publike, duke nënvizuar se përfshirja në proces nuk duhet të kushtëzohet domosdoshmërisht nga ekzistenca e projekteve të gatshme, por nga kontributi në përcaktimin e objektivave të përbashkëta.

Issues Raised: Mungesa e publikimit të pyetësorit nga Ministria e Arsimit në kuadër të procesit të konsultimit; Nevoja për përmirësimin dhe zgjerimin e edukimit ligjor dhe të integritetit në sistemin arsimor, veçanërisht në arsimin e mesëm;

Niveli i ulët i ndërgjegjësimit dhe angazhimit të të rinjve në këtë fushë;

Nevoja për koordinim më të mirë ndërmjet prioritetëve të qeverisë dhe atyre të organizatave të shoqërisë civile.

Feedback: U sugjerua forcimi i koordinimit ndërinstitucional dhe harmonizimi i objektivave ndërmjet qeverisë dhe organizatave të shoqërisë civile, si dhe rishikimi dhe përmirësimi i përmbajtjes së kurrikulave arsimore në funksion të rritjes së ndërgjegjësimit dhe angazhimit të të rinjve në fushën e integritetit dhe edukimit ligjor.

Name:	Znj. Mirela Arqimandriti	Organization/ Affiliation:	GADC	Position	:
--------------	---------------------------------	---------------------------------------	-------------	-----------------	----------

Comments/ Issues Raised /Feedback/ Ideas

Comments: Përfaqësuesja e GADC theksoi se organizatat e shoqërisë civile përballen me kufizime në aksesin në institucionet arsimore, duke evidentuar nevojën për miratim dhe mbështetje institucionale nga Ministria e Arsimit dhe strukturat përkatëse vendore (ZVA), me qëllim mundësimin e zhvillimit të aktiviteteve në shkolla.

Gjithashtu, ajo nënvizoi rëndësinë e rritjes së informacionit dhe ndërgjegjësimit në sistemin arsimor, përmes përfshirjes së përmbajtjeve të lidhura me edukimin ligjor dhe integritetin në kurrikulat shkollore.

Në vijim, u theksua se propozimet në kuadër të Planit të Veprimit duhet të jenë rezultat i një procesi të përbashkët dhe të dakordësuar ndërmjet institucioneve publike dhe organizatave të shoqërisë civile, duke marrë në konsideratë kapacitetet dhe burimet e disponueshme. U evidentua se mungesa e projekteve të financuara ndikon drejtpërdrejt në mundësinë për zbatimin efektiv të angazhimeve.

Sa i takon përmbajtjes së angazhimeve, përfaqësuesja mbështeti vijimësinë e angazhimit që lidhet me vlerësimin e riskut të korrupsionit, duke e konsideruar atë si një komponent të rëndësishëm që duhet të ruhet.

Gjithashtu, u theksua se angazhimi për forcimin e integritetit dhe transparencës në vendimmarrjen publike përbën një fushë ku organizatat e shoqërisë civile kanë një rol të rëndësishëm dhe pjesëmarrje të gjerë, duke e bërë atë një angazhim me potencial të lartë për zbatim.

Issues Raised: Gjatë diskutimit u evidentuan kufizime në aksesin e organizatave të shoqërisë civile në institucionet arsimore, për shkak të mungesës së autorizimeve dhe mbështetjes institucionale nga Ministria e Arsimit dhe strukturat vendore. U theksua gjithashtu mungesa e burimeve dhe projekteve të financuara, e cila ndikon në

zbatueshmërinë e angazhimeve, si dhe nevoja për një bashkëpunim më të strukturuar dhe të dakordësuar ndërmjet institucioneve dhe OSHC-ve.

Feedback: *U sugjerua forcimi i bashkëpunimit me Ministrinë e Arsimit për të mundësuar përfshirjen e OSHC-ve në shkolla, si dhe përmirësimi i edukimit ligjor dhe të integritetit në kurrikula. Gjithashtu, u theksua që angazhimet duhet të jenë të dakordësuara dhe të mbështeten në kapacitete reale zbatimi, duke ruajtur fokusin në vlerësimin e riskut të korrupsionit dhe në forcimin e transparencës dhe integritetit në vendimmarrjen publike.*

Name:	Znj. Vladimir Thano	Organization/ Affiliation:	Bashkëkryetar i Komitetit Shumëpalësh të PQH Albania	Position:	
--------------	----------------------------	---------------------------------------	---	------------------	--

Comments/ Issues Raised /Feedback/ Ideas

Comments: *Përfaqësuesi theksoi dakordësinë me shqetësimet e ngritura lidhur me nevojën për mbështetje institucionale nga Ministria e Arsimit dhe strukturat përkatëse vendore, me qëllim mundësimin e aksesit të organizatave të shoqërisë civile në institucionet arsimore dhe forcimin e edukimit ligjor në shkolla.*

Në vijim, ai nënvizoi rëndësinë e një qasjeje më të diferencuar dhe të bazuar në të dhëna nga organizatat e shoqërisë civile, duke evidentuar se problematikat dhe nevojat ndryshojnë sipas zonave gjeografike. U theksua se ndërhyrjet duhet të mbështeten në analiza dhe statistika konkrete, në mënyrë që shërbimet dhe aktivitetet të adresojnë në mënyrë efektive sfidat specifike, veçanërisht në zonat më të ekspozuara ndaj problematikave sociale dhe të integritetit.

Gjithashtu, u evidentua se organizatat e mëdha të shoqërisë civile kanë dhënë kontribut të rëndësishëm në këtë fushë, veçanërisht në drejtim të forcimit të integritetit dhe transparencës publike. Në këtë kuadër, u theksua potenciali i lartë i përfshirjes së tyre në angazhimet përkatëse, përfshirë edhe në kontekstin e iniciativave të reja ligjore që synojnë rritjen e llogaridhënies në vendimmarrjen publike.

Issues Raised: *U evidentua nevoja për një qasje më të strukturuar dhe të bazuar në të dhëna nga organizatat e shoqërisë civile, si dhe për adresimin e diferencave territoriale në lidhje me edukimin ligjor dhe çështjet e integritetit. Gjithashtu, u theksua rëndësia e mbështetjes institucionale për të mundësuar përfshirjen efektive të OSHC-ve në sistemin arsimor.*

Feedback: *U sugjerua që ndërhyrjet dhe angazhimet të bazohen në analiza dhe statistika konkrete, duke marrë në konsideratë dallimet ndërmjet zonave të ndryshme. Gjithashtu, u theksua rëndësia e përfshirjes aktive të organizatave të shoqërisë civile, veçanërisht atyre me eksperiencë, në angazhimet që lidhen me forcimin e integritetit dhe transparencës publike, si dhe në nisma që kontribuojnë në rritjen e llogaridhënies në vendimmarrjen publike.*

Name:	Znj. Mona Xhexhaj	Organization/ Affiliation:	MAPA	Position:	
Comments/ Issues Raised /Feedback/ Ideas					
Comments 1: <i>Përfaqësuesja e MAPA theksoi se formulimi i angazhimeve duhet të mbështetet në projektet ekzistuese ose ato të planifikuara për zbatim nga institucionet dhe organizatat, me qëllim sigurimin e realizueshmërisë dhe efektivitetit të tyre.</i>					
Issues Raised: <i>U evidentua nevoja për të lidhur angazhimet e propozuara me iniciativa konkrete dhe të zbatueshme, në mënyrë që të shmanget formulimi i angazhimeve që nuk mbështeten në kapacitete reale.</i>					
Feedback: <i>U sugjerua që procesi i hartimit të angazhimeve të orientohet nga projektet dhe aktivitetet konkrete në zbatim ose në planifikim, me qëllim rritjen e realizueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së tyre.</i>					

Name:	Znj. Elida Jata	Organization/ Affiliation:	ALTRI	Position:	
Comments/ Issues Raised /Feedback/ Ideas					
Comments: <i>Përfaqësuesja e ALTRI bëri me dije se organizata planifikon të angazhohet në projekte që lidhen me vlerësimin e riskut të korrupsionit në nivel vendor. Gjithashtu, ajo theksoi rëndësinë e përmirësimit të metodologjive ekzistuese, veçanërisht në drejtim të matjes së perceptimit publik, me qëllim rritjen e zbatueshmërisë së tyre. Në vijim, u nënvizua edhe rëndësia e edukimit të të rinjve dhe e rritjes së përfshirjes së tyre në proceset e transparencës dhe vendimmarrjes.</i>					
Issues Raised: <i>U evidentua nevoja për zhvillimin dhe përmirësimin e metodologjive të vlerësimit, veçanërisht në nivel vendor dhe në matjen e perceptimit publik, si dhe për rritjen e përfshirjes së të rinjve në çështjet e integritetit dhe transparencës.</i>					
Feedback: <i>U sugjerua mbështetja e angazhimeve që lidhen me vlerësimin e riskut të korrupsionit në nivel lokal, përmirësimin e metodologjive të matjes së perceptimit publik dhe forcimin e edukimit dhe angazhimit të të rinjve në proceset e transparencës dhe vendimmarrjes.</i>					

Name:	Znj. Rovena Pregja	Organization/ Affiliation:	DPAK	Position:	
Comments/ Issues Raised /Feedback/ Ideas					

Comments: *Përfaqësuesja e DPAK ngriti nevojën për të vlerësuar nëse organizatat e shoqërisë civile disponojnë projekte konkrete për realizimin e një vlerësimi të ri të riskut të korrupsionit në sektorët vulnerabël. Gjithashtu, ajo theksoi se DPAK, si institucion përgjegjës, duhet të përqendrohet në një numër të kufizuar angazhimesh, konkretisht 2–3, duke synuar ndërthurjen dhe konsolidimin e propozimeve ekzistuese.*

Në vijim, u diskutua nëse angazhimi që lidhet me zbatimin e kurrikulës së integritetit dhe informimit për luftën kundër korrupsionit në arsimin parauniversitar duhet të qëndrojë si angazhim më vete apo të integrohet në angazhime të tjera ekzistuese, veçanërisht në angazhimin 6.

Në përfundim, u bë me dije se drafti i parë i Planit të Veprimit do t'i paraqitet për shqyrtim Komitetit Shumëpalësh në muajin prill.

Issues Raised: *U evidentua nevoja për të siguruar që angazhimet të mbështeten në iniciativa konkrete dhe projekte të realizueshme, si dhe për të përcaktuar një strukturë më të qartë dhe të fokusuar të angazhimeve, duke shmangur fragmentarizimin e tyre.*

Feedback: *U sugjerua përqendrimi i angazhimeve në një numër të kufizuar dhe të integruar, si dhe vlerësimi i mënyrës më efektive të strukturimit të tyre, duke përfshirë mundësinë e integritetit të disa komponentëve në angazhime ekzistuese. Gjithashtu, u theksua vijimësia e procesit përmes hartimit dhe dorëzimit të draftit të parë të Planit të Veprimit për shqyrtim në fazën pasuese.*

Listëprezenca

Nr.	Emër Mbiemër	Institucioni
1	Rovena Prega	Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit
2	Elida Jata	Qendra ALTRI
3	Daniela Lulja	Qendra ALTRI
4	Rovena Sulstarova	IDM ALBANIA
5	Vladimir Thano	Bashkëkryetar i Komitetit Shumëpalësh të PQH Albania
6	Mirela Arqimandriti	GADC
7	Fabiola Egro	Anëtare e Komitetit Shumëpalësh të PQH Albania
8	Mona Xhexhaj	MAPA
9	Viktoria Spiro	DPAK
10	Hener Shanaj	DPAK
11	Artenisa Troksi	DPAK

Photos / Gallery



